

Strukturat e GI në Unia

Konferencat karakterizuese të Kongresit

2

Me 10 shtator 2016 në Bernë

Demonstratë gjithëzvicere

3

Pensionet dhe kthimi në vendin amë

çka vlen për qytetarët e BE-së

4

Nr. 4 | korrik 2016 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Hapja e tunelit bazik në Gotthard

Kryevepër e inxhinierisë dhe multikulturalizmit



Hapjen e tunelit bazik në Gotthard disa punëtorë e paguan me jetën e tyre

1 qershori 2016 ishte ditë feste në Zvicër. U festua hapja e tunelit bazik në Gotthard. Zvicra ka arsye të mjaftueshme të jetë krenare: Tuneli është një vepër shekullore. Dhe ai ndërlihet me historinë zvicere të migracionit. Për këtë duhet të jenë krenar edhe vet migrantët.

Tuneli i rekordeve

Tuneli bazik në Gotthard është një vepër ndërtimi që shënon rekord: me 57,1 km ai është tuneli më i gjatë hekurudhor në botë. Ai është ndërtuar në një thellësi deri në 2300 m. Sasia e materialit të përdorur për ndërtim të tij do të mund të shërbente për ndërtimin e 5 piramidave të Keopsit. Tuneli është pjesë e një rrjeti kompleks të tuneleve dhe boshteve. Edhe kostoja prej 12 miliarda frangash dyshohet të jetë rekorde.

Me këtë tunel të tretë në Gotthard përshpejtohet dukshëm lidhja për-

mes hekurudhës mes Zvicrës gjermano-folëse dhe asaj italiane-folëse. Pasi tuneli ka një pjerrësi të lehtë dhe rruga hekurudhore është e drejtë, trenat përmes tij mund të gjëmojnë me një shpejtësi prej deri në 250 km/orë. Tuneli vlen edhe si pjesë e çelësit të fundit në korridorin e transportit të mallrave nga Roterdami deri në Genua.

Një projekt evropian

Kështu tuneli bazik në Gotthard është edhe një projekt evropian, që për-fshihet në traditën e tunel-ndërtimit

të Zvicrës. Qysh me tunelin e parë në Gotthard, punët e të cilit kanë filluar në vitin 1872, ishte një projekt evropian: ai ishte financuar me 4/5 e parave italiane dhe gjermane.

Një dimension tjetër evropian i tuneleve zvicere është prejardhja e ndërtuesve të tij: tuneli i parë në Gotthard, Simplon (1898) dhe ai Lötschberg (1907) janë ndërtuar nga italianët. Në vitin 1860 në Zvicër jetonin 14000, me rastin e ndërtimit të shekujve ishin 117000 italianë dhe 158000 gjermanë. Kështu Zvicra qysh në fillim të shekullit të 20 ishte një vend migrimesh. Kështu ka mbetur deri më sot, përkundër momenteve të zvogëlimit të migrimeve dhe përpjekjeve të forcave të djathta populiste për të kufizuar apo penguar migracionin.

Një nxitje për ekonominë zvicere

Industria zvicere që nga shekulli i 19 ka nevojë dhe varet nga fuqia punëtorë jashtë vendit. Pas luftës së dytë botërore kjo nevojë u rrit edhe më shumë. Futja e statutit të stinorëve i dha Zvicrës mundësinë që sipas nevojave të marr fuqi punëtorë dhe ta kthejë atë prapa.

Megjithatë punëtorët e përkohshëm (mysafir) si qheshin atëkohë shiheshin me shqetësim. Thuhej se ata ua zinin vendet e punës zvicereaneve. Edhe pse ata kryenin punë që asnjë zvicerean nuk donte më ti kryente vet.

Një shoqëri shumë-kulturash

Numri i migrantëve u rrit në mënyrë konstante: Gjatë vitit 1980, 14.8 e banorëve ishin migrantë, ndërsa sot janë 25%. Shumë degë ekonomike në Zvicër pa ta nuk do të mund të funksiononin fare: ndërtimtaria, pastrimi, kujdesi, etj. Edhe për fuqi punëtorë me arsimim të lartë ka nevojë ekonomia e Zvicrës, pasi ajo vet nuk arsimon mjaftueshëm kuadro të reja për mbulimin e nevojave të saj. Shoqëria e sotme zvicereane ka kohë që është suksesshëm shumë-kulturore. Këtu jetojnë njerëz nga të gjitha kontinentet, ata flasin një laramani gjuhësh të ndryshme. Kryesorja ata me punën e tyre japin kontribut të rëndësishëm për suksesin e ekonomisë zvicereane.

Tuneli si simbol i shoqërisë së migrantëve

Ndërtimi i tunelit bazik në Gotthard është një simbol për këtë Zvicër. Ai është ndërtuar parasëgjithash nga punëtorët e huaj, të cilët vijnë nga vende të ndryshme të Evropës, bile fjala bie deri edhe nga Afrika e Jugut. Kjo është një kryevepër e tunelit. Dhe një kryevepër e bashkëpunimit e njerëzve me origjinë të ndryshme. Ndërtimi i tunelit ishte një projekt shumë-kulturore. Edhe për këtë arsye Zvicra duhet të jetë krenare si për tunelin ashtu edhe për ndërtuesit e saj. Ne migrantët gjithashtu.

Marilia Mendes

Editorial



Gotthard 2016

Më në fund u hap, vepra shekullore ndërtimore përmes alpeve, tuneli më i gjatë në botë.

U mbajtën shumë fjalime. Plot përmbajtje sikur aj i zonjës Merkel dhe i shumë të tjerëve. Kishte edhe një të përbashkët të fjalimeve, të shkrimeve të gazetave dhe emisioneve televizive. Askush nuk harroi të nderoi kontributin e madh të punëtorëve të ndërtimtarisë. Po, bile kishte edhe filma dokumentar të preکشëm e të mrekullueshëm për njerëzit që kishin ndërtuar tunelin. Që kjo ishte kështu duhet falënderuar jo së fundi sindikatave dhe punëtorëve luftarak. Luftë e zhvilluar në mënyrë të përsëritur me besim dhe forcë për drejtësi. As pronarët e ndërtimtarisë e as Zvicra zyrtare dhe para së gjithash firmat ndërtimore dhe planifikuesit nuk patën mundësi të injorojnë e anashkalojnë punëtorët e huaj shumicë të ndërtimtarisë dhe preokupimet e tyre. Ajo çka dëshironin planifikuesit e festimit, për rolin që sindikatat luajtën për ndërtimin e tunelit, ashtu edhe ia dolën, që ta fshihnin nën dysheme. Mjerisht kësaj ata edhe ia arritën.

Mirëpo, përvojat që ne mundëm të mbledhim me rastin e përkujdesjes së kantierëve në NEAT-it nuk mund të na i marrim askush. Evropa reale e punës në Gotthard ishte duke bashkëvepruar në një hapësirë të ngushtë. Duheshin tejkaluar barrierat gjuhësore. Mund dhe duhej mësuar kulturat e ndryshme. Për ne sindikalistët por edhe për punëtorët mes veti, por edhe inxhinierët ishin të sfiduar.

Punët në beshkë ndihmojnë që të menaxhojmë sfidat tona Vetëm ekipi fiton kundër shkëmbit. Dhe ajo që vlen gjatë ditës, vlen edhe atëherë kur duhet luftuar për të drejtat dhe kërkesat. Punëtorët në Gotthard edhe përkundër vështirësive kanë mësuar këtë leksion jetësor. Andaj edhe kanë fituar betejat e tyre.

Roland Schiesser

Anëtar i drejtorisë së sektorit të ndërtimtarisë



Kolegët e nderojnë ndërtuesit e tunelit bazik në Gotthard

News

Këshilli i kantoneve zhyt ligjin për orarin e shitoreve



Këshilli federal i përbërë nga përfaqësuesit e kantoneve ka refuzuar përfundimisht ligjin federal për orarin e punës së shitoreve. Ligji i ri do të përkeqësonte masivisht kushtet e punës në shitje. Për të përmirësuar kushtet e punës në tregtinë me pakicë, Unia kërkon me urgjencë një Kontratë nacionale kolektive të Punës. Ligji i ri erdhi në shprehje në bazë të presionit nga tregtaruesit e mëdhenjë. Ata donin të impononin orarin minimal të detyrueshëm të punës nga ora 6 deri 20 ditëve të punës dhe nga ora 6 deri 18 të shtunave në të gjitha Kantonet. Për shumicën e kantoneve dhe të personelit shitës aprovimi i ligjit do të paraqiste 60% më shumë orar pune për shitoret se sa është sot.

Punëtorët e ndërtimtarisë kërkojnë

«ndërtim korrekt»

Punëtorët e ndërtimtarisë u takun të shtunën e 11 qershorit në Bernë në konferencën e ndërtimtarisë. Konferenca e ndërtimtarisë të sektorit të ndërtimit të Unia-s dha shenjë për fillimin e fushatës «ndërtim korrekt». Në një manifest të tyrin, njerëzit e ndërtimtarisë kanë precizuar se çka domethënë për ta mbrojtja e shëndetit dhe ndërtim korrekt. Manifesti emërton problemet në ndërtimtarinë dhe ka për qëllim të sensibilizojë të gjithë të përfshirët e degës së ndërtimtarisë për problematikën. Fushata u drejtohet punëtorëve të ndërtimtarisë, kryepunëtorët dhe kuadrot e ndërtimtarisë, mirëpo edhe pronarëve dhe shoqatës së ndërtimit, të cilët duan që të angazhohen për degën korrekte dhe të shëndoshë të ndërtimtarisë.

Unia ndien keqardhje për shkurtime në General Electric

General Electric (GE) ngul këmbë për reduktim të 1.100 vendeve të punës në Aargau. Kjo është një goditje e rëndë për Zvicrën si vendpunishte. Presioni publik megjithatë ka kontribuar për krijimin e 172 vendeve të reja të punës. Korporata GE e SHBA-ve ndjek linjen e saj të rreptë: Deri në fund të vitit 2017 në Kantonin Aargau duhet të reduktohen 1300 vende pune: 900 përmes shkarkimeve, pjesa tjetër përmes pensionimit të parakohshëm si dhe largimeve «vullnetare». Kështu GE venë aksionet fitimpruese afatshkurtesa mbi interesat e të punësuarëve. Një pikë e vogël plus: Presioni i madh publik dhe Unia me bashkëudhëheqjen e bisedimeve kanë arritur që GE në Aargau të krijojë 172 vende të reja pune. Afatet për shkarkim nga puna të punonjësve të prekur do të zgjatet edhe për dy muaj tjerë, çka atyre u mundëson më shumë kohë për të kërkuar vend të ri pune.

Organet e Unia-s, Përgaditjet për Kongres

Konferencat karakterizuese të Kongresit



Pamje të punimeve të Konferencës së migracionit të mbajtur me 28 maj 2016

Konferenca e sivjeme e migracionit, ashtu sikur edhe ajo e rrsisë dhe grave të Unia-s, u morr kryesisht me rrjedhat e Kongresit të ardhshëm. Mirëpo edhe temat tjera gjetën vend, si fjala bie në konferencën e migracionit situata e refugjatëve.

Grupi i interesit i migracionit, ashtu sikur ai i grave dhe rrsisë kanë të drejtë të shtrojnë parashtrësia për Kongres e rregullt të Unia-s, i cili do të mbahet në fund të tetorit 2016 në Gjenevë. Përmes këtyre parashtrësive grupi i interesit të migracionit mund të merr qëndrim rreth strategjisë së sindikatës Unia për katër vitet e ardhshme si dhe të ndikojë për tema të ndryshme.

Zgjedhja e presidencës së re
Pos diskutimeve të parashtrësive konferenca e migracionit ka zhvilluar edhe zgjedhjet për periudhën e re kongresore. Krahas zgjedhjeve të delegatëve të saj për Kongres dhe për Mbledhjen e delegatëve, grupi i interesit për migracion ka nominuar edhe përfaqësuesit e saj për kryesinë qendrore si dhe ka zgjedhur presidencën e re prej dy vetash. Për presidencë të punimeve të komisionit dhe konferencës së migracionit janë zgjedhur Alexandrina Farinha dhe Tobias Goldmann. Urime të përzemërta të gjithë të zgjedhurve!

Refugjatët & guximi qytetar
Një pjesë e konferencës iu kushtua edhe refugjatëve. Shpjegimet e sekretares për rini në Unia, Lena Frank dhe

aktivistes Diana Hinz kanë prekur së tepërmi pjesëmarrësit e konferencës, ashtu sikur edhe ndarja e çmimit për guxim qytetar Diana Hinz, gjë që shkaktoi mjaft emocione.

Gratë kërkojnë bartazi në paga

Një fundjavë më herët gjithashtu edhe gratë kishin konferencën e tyre. Këtu tema kryesore ishte barazia. Që nga koha kur janë krijuar raporteve të reja të shumicës parlamentare në Bernën federale, barazia e grave në punë dhe shoqëri nuk është më prioritet. Gratë e Unia kërkojnë që qeveria federale të shtyjë përpara ligjin mbi barazinë dhe të përdorë instrumente frytëdhënëse. Rritjen e moshës së pensionimit ato e luftojnë në të gjitha mënyrat.

PO për AHV/AVSplus

Së fundi, në fillim të qershorit rri- nia e Unia-s zhvilloi konferencën e saj, posaçërisht mbi temën e pensionimit AHV/AVSplus. Pë rrinë në Unia sigurimi i pensionit të pleqërisë dhe trashëgimtarve (AHV/AVS) me modelin e saj financues dhe mekanizmin e ndarjes së drejtë paraqet garancinë e vetme dhe afatgjatë për pensione të sigurta. Pikërisht për njerëzit e rinj AHV/AVS është përkudjesi më i lirë për moshë të shtyer me raportin më të mirë çmim-preformancë. Andaj ia vlenë mbrojtja kundër sulmeve të shkrutimeve në AHV/AVS – veçanëisht në interes të generatës së re.

Aurora García

Migrantët-kujdestar

Kushte më të mira pune për kujdestaret e të moshuarve

Migrantët që punojnë në përkujdesje kryejnë një punë të rëndësishme dhe të vështirë për mirëqenien e të moshuarve, mirëpo shpesh ata paguhen keq dhe shfrytëzohen. Që nga 1 maji vlen gati për të gjitha firmat kujdestare KKP për huazimin e personelit. Trajnime të paguara, kompensim të rimbursim-zbatimi, paga minimale dhe më shumë pushim vjetor, janë vetëm disa nga përmirësimet për kujdestaret e të moshuarve.

Përditë punojnë me mijëra punëtor migrantë/e që kujdesen për tu ndier mirë të moshuarit tanë. Ata punojnë shtëpi private dhe kujdesen me shumë aftësi e dashuri për personat që iu janë besuar atyre. Ata gatujnë për ta, ju kryejnë atyre punët e shtëpisë, ju ndihmojnë në formësimin e përditshmërisë dhe përkujdesen për ta. Puna e tyre është e rëndësishme dhe e ashpër për të gjithë ne. Pasi në të gjithë dëshirojmë për veten dhe prindërit e gjyshërit tanë përkujdes të mirë në moshë të shtyrë. Migrantët kujdestarë vijnë nga të gjitha vendet e mundshme dhe shpesh kanë arsimim të mirë. Mirëpo, mjerisht kushtet e këqija të punës për ta janë bërë rregull. Pagesat janë shpesh të ulëta, deri edhe 5 franga për orë. Shumë kujdestar/e janë tërë kohë në dispozicion, pa asnjë orë punë të kontraktuar dhe pa punësim apo kontratë të përhershme pune. Disa duhet të punojnë 24 orë në ditë,

deri edhe 30 ditë pandërprerë dhe pa asnjë pauzë. Spitex-et private dhe firmat kujdesie përfitojnë në kurriz të tyre. Për të ndalur shfrytëzimin e tyre duhet të angazhohemi të gjithë ne bashkë me sindikatën Unia.

Një fillim i mirë

Hapi i parë për kushte më të mira pune vlen së fundi nga 1 maji 2016. Nga kjo kohë të gjitha firmat private për përkujdesje duhet ti bashkëngjiten KKP për personelin e huazuar dhe do të kontrollohen se a i respektojnë kushtet e punës. Kjo paraqet përmirësime të shumta për kujdestarët e të moshuarve. Paga e 13-të dhe pagat minimale tanimë janë të detyrueshme. Rishtas vlen për ta orari javor 42 orësh. Nga 9.5 orë e tutje duhet të paguhet një shtesë 25% për orë. Kujdestarët/et mbi 50 vjeç kanë një javë më shumë pushim vjetor. Kush punon më shumë se 176 orë në vit, trajnimet ne kushte të caktuara do të



Kujdestar/eve migrant/e të kenë kushte më të mira pune

mbështeten me deri në shumën 5000 franga dhe do merret përsipër kompensimi i pagës së humbur deri në shumën 2300 franga. Dhe gjithashtu si risi anëtarët e sindikatës përfundimisht marrin prapa kompensimin e 80% të shumës së kontributeve për anëtarësi. Mirëpo KKP e re është vetëm një hap i parë. Shumëçka duhet ndryshuar. Edhe më tej grupet tona të kujdestarëve nga Evropa e mesme dhe veriore në Unia luftojnë për kushte më të mira pune. Në Tiçino para pak kohësh u mbajt një tubim me mbi

100 kujdestar/e, të cilët kërkojnë një KKP. Në Cyrih dhe St. Gallen ky grup zbuloi raste të ndryshme të dumpin- gut të pagave. Unia nxori në muajin maj një broshurë në gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe polonisht me titullin «Të drejtat e mija në kujdesin për të moshuar». Kurse të gjermanishtes dhe intervenime polake janë planifikuar. Në korrik Unia fillon një fushatë informative për migrantët kujdestarë. Pasi një gjë është e qartë, për kujdestari e përkujdes të mirë nevojiten kushte të mira pune.

Adrian Durtschi dhe Adam Rogalewski

Demonstratë gjithë-zvicerane
Të shtunën, me 10 shtator 2016, Në ora 13.30 në Bernë

Stop reduktimin e pensioneve – të forcojmë AHV/AVS



Të gatshëm për të luftuar për forcimin e AHV/AVS

Demonstratë gjithë-zvicerane
Të shtunën, me 10 shtator
Në ora 13.30 në Bernë

Të sigurohet vend punishtja – të mbrohen vendet e punës

Vendimi i gabuar i Bankës Kombëtare për heqjen e kursit minimal të këmbimit për euro ka kushtuar tashmë dhjetëra mijëra vende pune. Zvicra aktualisht kërcënohet të de-industrializohet. Përmes demonstratës ne vejmë një shenjë e qartë për një politik monetare dhe industriale që mbron dhe promovon hapësirën e vend-punës.

Osman Osmani

- AHV/AVSplus në vend të shtyrjes së moshës së pensionimit dhe vjedhjes së pensioneve
- Stop dumpingut në paga – më shumë mbrojtje për të gjithë
- Sigurimi i vend-punishtes – mbrojtje e vende të punës
- Kundër shkurtimit të taksave për bizneset

Stop reduktimin e pensioneve – të forcojmë AHV/AVS

Kushdo që ka punuar gjithë jetën e tij, duhet të jetë në gjendje të jetojë me dinjitet nga pensioni i tij në moshën e pleqërisë. Por realiteti është ndryshe: Pensionet e fondeve të pensioneve janë duke rënë dhe pensionet e pagat e sigurimit të pensionit të pleqërisë dhe trashëgimtarëve AHV/AVS po mbesin gjithnjë e më prapa. E djathta ndjek linjën e ashpër dhe duan që të rrisin moshën e pensionit në 67 vjeç, duke planifikuar një vjedhje tjetër gjigante të pensioneve. Të dërgojmë një shenjë të qartë me një

demonstrim të fuqishëm ndaj këtyre sulmeve?

Të zgjerojmë mbrojtjen e pagave – të luftojmë dumpingun në paga!

Shoqatat e punëdhënësve, qeveria federale dhe shumica e djathtë në Parlament po kundërshtojnë të mbrojnë në mënyrë të vendosur pagat dhe kushtet e vlefshme të punës në Zvicër. Të angazhohemi që me 10 qershor në Zvicër të japim një mesazh të qartë për zgjerimin e masave mbrojtëse gjithëpërfshirëse, për qarkullimin e lirë të personave dhe më shumë mbrojtje për të gjithë.

25 shtator: Po për AHV/AVSplus!

Iniciativa popullore e sindikatave kërkon të forcojë AHV/AVS si kolonën më të rëndësishme, më të qëndrueshme dhe të financuar me solidaritet. Të gjitha pensionet të rriten për 10%. Një rritje e lehtë nga kontributet e pagave nga të punësuarit dhe punëdhënësit me 0.4% janë të mjaftueshme për të financuar këtë rritje. AHV/AVSplus është përgjigja jonë ndaj sulmeve mbi pensionet dhe moshën e pensionit dhe kundër rënies së vazhdueshme të pensioneve nga fondi i pensioneve.



www.ahvplus-initiative.ch

Raporti i Seco tregon: Shumica e Kantoneve punon keq

Gati 20 raste të dumpingut në paganë ditë

Raporti më i ri i Sekretariatit Shtetëror për Ekonomi (Seco) mbi masat mbrojtëse gjithëpërfshirëse (FlaM) tregon: Sa përket mbrojtjes së agave dhe kushteve të punës është nevojshme të veprohet. Për Unia është e qartë, në rast dyshimi për dumping në paga duhet të ndalen punimet. Përndryshe masat mbrojtëse gjithëpërfshirëse rrezikojnë të duken si një tigrë pa dhembë prej letre.



Nevojiten më shumë kontrole nga ana e Kantoneve

Kantonet mund të veprojnë me vendosmëri kundër shtypjes së pagave. Mirëpo shumica e tyre nuk veprojnë fare. Numrat janë të zymtë. 5341 herë në vitin e kaluar kontrolluesit e pagave kishin dyshime se firmat nuk po i përmbahen pagës minimale. Kjo i bie 15 herë në një ditë alarm përkitazi me dumpingun në paga vetëm në degët me Kontratë të vlefshme Kolektive të Punës. Pos kësaj duhet shtuar edhe 5 raste në ditë për degët a KKP. Bashkërisht bëhen rreth 20 raste në ditë. Dhe këto janë vetëm shifrat që zbulohen dhe që përfundojnë tek statistikat e Sekretariatit Shtetëror për Ekonomi (Seco).



Kantonet duhet të veprojnë

Kontrolluesit e Bernës vitin e kaluar kanë vendosur 67 ndalime pune, pasi kishin zbuluar shenja të vetëpunësimi të rremë. Një mashtrim i popullarizuar: Firmat detyrojnë punëtorët të punojnë për një pagë-lëshosh dhe i deklarojnë ata si të vetëpunësuar. Kështu nuk vlen paga minimale. Shpesh firmat tek pas ndalimit të punës janë të gatshme që të qesin letrat mbi tavolinë. Mirëpo vetëm Kantonet e Bernës dhe Gjenevës zbatojnë masat në mënyrë konsekuente. Shumica e Kantoneve në vitin 2015

nuk kanë vendosur asnjë ndalesë të vetme pune. Ndër to edhe Kantoni ekonomik e Cyrihut.

Katastrofë

Për njeriun e Unia-s Nico Lutz kjo gjendje është e pa tolerueshme: «Disa Kantone punën e tyre e bëjnë të rëndësishme keq.» Në rrafshin federal ndodh fare pak e thuaja se hiq, për të vënë në kontroll shtypjen e pagave. Tanimë nevojiten me urgjencë hapa tërësisht tjerë. Drejtuesi i ndërtimtarisë në Unia, Nico Lutz kërkon “më shumë kontrole, instrumente më të mira dhe më shumë paga minimale”. Kështu do të bëhej më e thjeshtë për të deklaruar KKP me vlefshmëri të përgjithshme.

Osman Osmani

Intervistë



Beat Baumann, ekonomisti i Unia-s

Reforma tatimore III e korporatave

Reforma tatimore e ndërmarrjeve III aktualisht gjendet në diskutimin parlamentar. Horizonte bisedoi me Beat Baumann, ekonomistin e Unia-s se me çka ka të bëjë kjo reforme tatimore dhe çfarë konsekuencash ka ajo për ne.

Beat, a mund të na shpjegosh, çka saktësisht domethënë kjo reformë tatimore?!

Zvicra ka cytur dhe tërhequr ndërmarrjet e huaja me privilegje tatimore e përparësi tjera. Me presionin e BE-së privilegjet duhet të mënjanohej, gjë që është në rregull. Për të mos u tërhequr këto ndërmarrje në vendet jashtë Zvicre, Kantonet duan që të ulin përqindjen e tatimit në fitim për të gjitha ndërmarrjet.

A shkakton kjo humbje të mëdha tatimore?

Po, fjala është për 1,2 miliardë franga vetëm në nivelin federal, pos kësaj shkaktohen humbje tatimore edhe tek Kantonet. Ideja është që federata dhe kantonet të japin më shumë para nga tatimi federal, për të pasur këto pastaj hapësirë të zvogëlimit të tatimit në fitim për të gjitha ndërmarrjet.

Cilat janë konsekuencat e kësaj reforme tatimore?

Ndërmarrjet do të marrin dhurata tatimore me enë ujitjeje. Mirëpo paratë do të investoheshin më mirë për një politikë industriale dhe shërbimesh si dhe për ndërtimin ekologjik e social. Spektri i majtë politik dhe Kantonet po kërkojnë gjithashtu edhe masa kompozuese. Me reformën e dytë tatimore të ndërmarrjeve, tatimi e dividendëve ishte reduktuar për 50%. E majta dëshiron që të gjitha të ardhurat nga dividendët të ngarkohen me tatim 100%, për të kufizuar humbjet tatimore. Kantonet dëshirojnë që dividendët të kenë tatim së paku me 60%.

Cili është qëndrimi i këshillave federale për këtë çështje?

Komisioni i Këshillit Federal të përbërë nga përfaqësuesit e Kantoneve ishte i gatshëm të vlerësoj tatimin e pjesshëm të dividendëve, që Kantonet të kenë më shumë të hyra. Parlamenti federal i përbërë nga përfaqësuesit e partive pulitke ishte kundër.

Çka është duke synuar Parlamenti?

Të dyja dhomat nuk duan vetëm një pjesë më të lartë të tatimeve federale për Kantone, porse të krijojnë dhe privilegje të reja tatimore, p.sh. për humlumtim dhe zhvillim apo edhe nga të ardhurat e patentimeve. Ato shfrytëzojnë këtë temë që në çështjet tjera të favorizojnë ekonominë.

Dhe cilat do të ishin konsekuencat për punëmarrësit?

Më pak të ardhura tatimore domethënë reduktim për Kantonet dhe për Federatën. Në sektorin publik përmes kësaj rrezikohen edhe vendet e punës.

PS ka paralajmëruar referendum. Cili është qëndrimi i BSZ dhe Unia-s?

Favorizimi i ekonomisë është i tepruar. Andaj BSZ (Bashkimi i Sindikatave të Zvicrës) dhe Unia mbështesin referendumin. Unia gjatë verës do të mbledhë nënshkrimet e nevojshme, që popullui të ketë mundësinë të votojë mbi këtë mësymje të radhës mbi tatimet.

Cila do të ishte për ne reforma e mirë tatimore për ndërmarrje?

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme nuk paraqesin problem, por korporatat trans nacionale, të cilat i zhvendosin fitimet dhe u shmangen tatimit. Vetëm në vendet e BE-së ka pasur një mashtrim prej 170 miliardave të të ardhurave tatimore. Këtë e vërtetojnë edhe shkrimet në gazetën Panamapapiers dhe Luksemburgu-Leaks. Tatimi korrekt ndodh vetëm atje ku janë krijuar vlerat. Tani të krijojnë privilegje të reja tatimore, të cilat pas një kohe do të ndalojnë, është mënyrë e të menduarit afatshkurtër. Modeli i biznesit «Zvicra paraqesë tatimore» nuk të ardhme, në vend të saj ne duhet të angazhohemi për fuqi të mirë pune në vendin tonë.

Marilia Mendes



Reforma tatimore III e korporatave

Kthimi i qytetarëve të BE-së që banojnë në Zvicër

Pensionet dhe kthimi në vendin amë

Shumë migrantë e migrantë, që kanë ardhur për të punuar në Zvicër, pas pensionimit të tyre dëshirojnë të kthehen në vendet e tyre amë. Në këtë shkrim do të trajtojmë kthimin e qytetarëve të BE-së nga Zvicra, të cilët duan të marrin pensionin në një nga shtetet anëtare të BE-së*. Parimet e marrjes së këtyre pensioneve janë të rregulluara me Marrëveshjet për qarkullimin e lirë të personave, e cila koordinon sistemet e ndryshme nacionale të sigurimeve shoqërore.

Pensioni AHV/AVS

Shtetasi i një shteti anëtar i BE-së në parim ka të drejtë në përfitim të pensionit të tij të AHV/AVS jashtë Zvicre. Para largimit nga Zvicra duhet të informojë arkën përgjegjëse të kompensimit të AHV/AVS (informata tjera gjeni në:). Kjo dorëzon dosjen e të larguarit arkës nacionale te kompensimit që ka selinë në Gjenevë. Përfituesit/et e pensionit të AHV/AVS mund të zgjedhin lirshëm se a duhet tu paguhet pensioni në një konto-adresë në Zvicër apo në botën e jashtme. Përfitimet e pensionit të AHV/AVS normalisht paguhet në valutat e vendeve përkatëse ku gjendet konto-adresa.

E drejta e përfitimit nga pensioni vlen posa të jetë arritur moshja e vlefshme e pensionit në Zvicër (gratë me 64 vjet, burrat me 65) dhe kur dëshmohet minimumi i kohës së siguruar prej një viti. Lartësia e pensionit të AHV/AVS përllogaritet në bazë të viteve të siguruar në Zvicër. Personat, të cilët kanë paguar kontribute të sigurimeve në më shumë se një vend kontraktues, kanë të drejtë në pensione të veçanta të vendeve gjegjëse. Parakusht është që të kenë paguar kontributet e parapara minimale prej një viti në sigurimet në fjalë. Mungesat e viteve të kontributeve të papaguara kanë si pasojë shkurtime në pensione të AHV/AVS. Një vit i munguar kontributesh në parim qon në shkurtime së paku prej 2,3%. Nuk ka ndikim në pensionet zvicerane të AHV/AVS, nëse një person merr pension pleqëria nga shteti i BE-së.

Kujdes: Kompensim-shtesat për nevojtarët e pafuqishëm apo shtesat suplementare me largimin jashtë Zvicre humben. Këto përfitime i gëzojnë vetëm personat, që kanë vendbanim në Zvicër.

Pensioni i trashëgimtarëve

Pensionet zvicerane të trashëgimtarëve (të vejat, vejanët dhe jetimët) u paguhet atyre që kanë këtë të drejtë, e që kanë vendbanim në një shtet të BE-së, dhe atë me kushte të njëjta. Kjo vlen qoftë në rast se vendbanimi qysh në fillim të së drejtës të përfitimit gjendet në një shtet të BE-së, qoftë edhe me ndërrimin e mëvonshëm të vendbanimit në një shtet të BE-së. Pajesa e pensionit zviceran në një shtet të BE-së nuk ka ndikim në lartësinë e këtij pensioni. Megjithatë duhet pasur parasysh që personi i mbetur vejan/e ve e që ka arritur në moshën e pensionit të pleqërisë, nuk mund të përfitojë njëkohë-

sisht nga pensioni i pleqërisë dhe ai i trashëgimtarëve. Në këtë rast ti paguhet përfitimet më të larta.

Pensioni i invaliditetit IV/AI

Bazuar në Marrëveshjen bilaterale për qarkullim të lirë të personave, shtetasit e BE-së do të trajtohen njëjtë sikur edhe shtetasit zviceranë. Lidhur me parakushtin e periudhës minimal prej 3 vjetësh për një pension të rregullt në shtetet e BE-së dhe shtetet e EFTA-s do të merren parasysh kontributet e fituara kohore. Megjithatë duhet të jenë paguar së paku për një vit kontributet në Zvicër. Me rastin e kthimit në njërin nga vendet amë të BE-së pensionet zvicerane të invaliditetit do të paguhet sipas kushteve të njëjta sikur në Zvicër. Kush posedon të drejtën për përfitime, duhet të parashtrijë kërkesën gjegjëse. Me rastin e vendbanimit në një shtet të BE-së, lajmërimi për përfitimin nga pensioni zviceran i invaliditetit mund të dorëzohet tek bartësit e sigurimeve të vendit banues. Ata e dërgojnë atë për përpunim më tej tek sigurimet përgjegjëse.

Pensionet e sigurimet profesional BVG/LPP

Me rastin e sigurimet profesional përkujdesja minimale ligjore është në përgjegjësi të Marrëveshjes për qarkullim të lirë të personave dhe mallrave. Përfitimet nga fondi i sigurimeve të pensioneve profesionale paguhet pavarësisht nga vendbanimi. Parashtrësia për përfitime nga fondi i pensioneve profesionale duhet të bëhen drejtpërdrejtë tek institucioni i siguruar, të cilin e ka pajtuar punëdhënësi i personit përkatës. Nëse kursimet gjinden në një llogari rrjedhëse përkujdesjeje apo polisa gjegjëse e sigurimit, parashtrësia duhet të bëhet drejtpërsëdrejti në institucionin gjegjës (Fondacion bankar apo sigurim). Një pagesë e përfitimit në të holla në fushën e pensionit minimal të detyrueshëm është i ndaluar, kur një person është në marrëdhënie pune dhe lë përgjithmonë Zvicrën dhe në një vend të BE-së duhet të ketë sigurim të detyrueshëm për rreziqet e pleqërisë, vdekjes dhe paaf-tësisë. Pjesa e detyrueshme e përfitimeve të kushtëzuara duhet të transferohen në një llogari vetjake përfitimi ose në një polisë sigurimi të personit të siguruar. Pjesa jo e detyrueshme e përfitimeve vetjake në rast të largimit nuk i përket ndalimit dhe kështu ajo mund të paguhet paraprakisht në para të gatshme. Përdorimi i kursimeve nga fondi pensional profesional për nevoja personale banimi është i lejuar, nëse personi i siguruar, gjegjësisht familja e tij shfrytëzon vet objektin banesor.

* Bashkimi Evropian aktualisht përbëhet nga 28 shtete anëtare: Belgjika, Bullgaria, Danimarka, Gjermania, Estonia, Finlanda, Franca, Greqia, Irlanda, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Austria, Polonia, Portugalia, Rumania, Suedia, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Republika Çeke, Hungaria, Britania e Madhe, Qipro.

Philip Thomas



Ju pyesni, Unia përgjigjet

Bebja ime është sëmurë: A mund ta shtyjë pushimin tim të lehonisë?

Fëmija ynë i porsalindur është sëmurë dhe për këtë arsye duhet të qëndroj në spital së paku edhe katër javë. Punëdhënësi im më ka sugjeruar të shtyjë marrjen e pushimit tim të lehonisë. A është diçka e tillë fare e mundshme dhe çfarë më duhet të bëj?

Po kjo është e mundur. Normalisht e drejta e pushimit të lehonisë fillon me ditën e lindjes dhe përfundon më së voni pas 14 javësh. Nëse të porsalindurit menjëherë pas lindjes së paku tri javë duhet të qëndrojnë në spital, ju si nënë mund të parashtroni kërkesën që pushimi juaj i lehonisë të filloi me kthimin e fëmijës tuaj në shtëpi. Për këtë duhet të bëni me sa vijon: Përmes punëdhënësit tuaj mund të bëni të vlefshëm të drejtën tuaj tek arka kompetente për kompensim e AHV/AVS. Kërkoni nga mjeku juaj vërtetimin përkatës dhe dërgojeni tek punëdhënësi juaj. Ky këtë vërtetim ia dërgon më tej arkës përgjegjëse të AHV/AVS. Nëse gjithçka të jetë në rregull, arka do të aprovojë shtyrjen. Me që ra fjala: Të drejtën për kompensim në rast lehonie kanë gratë vetëm atëherë, kur janë të siguruar detyrimisht në përputhje me ligjin e sigurimeve shoqërore AHV/AVS nëntë muaj para lindjes së fëmijës, pra nëse banojnë në Zvicër ose janë në marrëdhënie pune. Dhe nëse në këtë kohë kanë qenë të punësuar së paku pesë muaj.

Philip Thomas, work, 2.6.2016

Dega e pastrimit: Sa pushim vjetor për një vit?

Jam 54 vjeç dhe që nga 1 janari 2012 punoi në të njëjtën ndërmarrje pastrimi në Kanton të Cyrihut. Kolegu im 19 vjeçar në vitin e parë ka 5 javë pushim vjetor në vit. Mua shefi im donë edhe më tej të më japi vetëm 4 javë. A nuk kam unë të drejtë që nga moshja 50 vjeçare të kem 5 javë pushime vjetore në vit?

Jo. Firma duhet detyrimisht të punësuarve t'ju japi 4 javë pushime vjetore në vit. Kështu qëndron në Nenin 329a të së drejtës obliguese. Punëmarrësit e rinj në të kundërtën deri në mbushjen e moshës 20 vjeç kanë të drejtë në 5 javë pushime vjetore në vit. Qoftë se janë duke vijuar arsimimin profesional apo jo, nuk është përcaktuese. Rregulla speciale për punëmarrësit e moshuar nuk ka. Kujdes: E drejta obliguese përcakton mjerisht vetëm të drejtën e pushimeve minimale vjetore. Në Kontratat Kolektive të Punës (KKP) dhe Kontratat e Veçanta të Punës shpesh janë kontraktuar më shumë pushime vjetore, varësisht nga moshja dhe përvoja e punës. Kjo ka të bëjë edhe me ju: Për ju vlen shifra 15.1 e KKP të vlefshme detyrimisht për degën e pastrimit në Zvicrën gjermane. E drejta e juaj për pushim vjetor nga moshja 50 vjeç është 5 javë në vit, mirëpo vetëm atëherë kur ju të keni punuar së paku 5 vite në firmën ku jeni i punësuar. Pasi në rastin tuaj kjo vlen nga fundi i vitit 2016, ju që nga viti 2017 do të keni 5 javë pushime vjetore në vit.

Peter Schmid, work, 4.5.2016

Impressum: **Bellage zu den Gewerkschaftszeitungen** work, area, Événement syndical | **Herausgeber** work, Gewerkschaft Unia, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | **Redaktionskommission** A. García, A. Rogalewski, D. Filipovic, E. Sariasslan, M. Martin, M. Mendes, O. Osmani | **Sprachverantwortlich** Osman Osmani | **Layout** C. Lonati, Unia | **Druck** Tagblatt Print, Im Feld 6, 9015 St. Gallen | **Adresse** Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft. Le Syndicat. Il Sindacato.

www.unia.ch